

Në vitin 1913 doli vëllimi i parë i «Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia» (cit. AA) nga tipografia e Adolf Holzhausen-it në Vjenë. Shtytjen për këtë ndërmarrje të pastër shkencore e pati dhënë që në vitin 1906 dr. Ludwig Thallóczy, shef seksioni në ministrinë e dikurshme të përbashkët (boshnjake) të financave në Vjenë, dhe më vonë adjutant civil i administratës ushtarake në Serbi.

Si fillestar ai pikësëpari u pat marrë me historinë e mesjetare hungareze. Duke pasur këtë parasysh, ai i zgjeroi pak e nga pak hulumtimet e tija në Sllavinë e vjetër dhe në Kroacinë bregdetare, e pastaj në Bosnje, në Serbi; rreth marrëdhënieve të anzhuinëve me bullgarët dhe në fund edhe në Shqipëri². Në këto kërkime më të vonshme u bashkua fillimisht me Konstantin Jirečekun e lavdishëm dhe pastaj edhe me mua. Në vitin 1907 mua m'u besua redaktimi i *Acta*-ve arbërore. Jirečeku përcillte vëllim për vëllim materialin e tij nga arkivi i Dubrovnikut ndërsa unë sipas arsytimit tim, e ndava këtë material në periudha, e grupova dhe sipas nevojës e plotësova sipas burimeve [dokumentare]. Thallóczy kryesisht ndërhyri për shtesat e dokumenteve të kopjuara nga Venediku, Vatikani, Napoli si edhe për shtesat e nxjerra nga *regesta*-t e Hopf-it nga Berlioni.

Si u veprua për grumbullimin, për përzgjedhjen dhe botimin e këtyre dokumenteve kjo është shpjeguar tek parathënia e vëllimit I. Aty është shfaqur edhe mendimi se kjo punë duhej të ndahej në katër vëllime, deri në vitin 1479, kur Shkodra ra në dorë të turqve.

Në çerekun e parë të vitit 1918 doli në dritë edhe vëllimi II i këtyre *Acta*-ve i cili përfshin deri vitin 1406. Botimin e këtij Thallóczy nuk e priti († 1 dhjetor 1916). Jirečeku vdiq pikërisht kur tashmë ishte shtypur edhe parathënia e vëllimit II, tek e cila shprehet një nderim i detyrueshëm ndaj të ndjerit Thallóczy. Në këtë kohë ndodhi edhe shpërbërja e Fuqive Qëndrore, të thyerit e monarkisë austro-hungareze. Këto dy vdekje dhe tërmeti i fuqishëm politik i shkundën themelet e AA, të kësaj ndërmarrjeje shkencore.

Megjithatë, botuesi Holzhausen m'u drejtua mua dy herë më vonë

- 1 «Acta Albaniae, kako da se nastavi njihovo izdanje?» *Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju*, knjiga III, sv. 1-2, Beograd 1926, 209-212. Përkthehet dhe botohet për herë të parë në gjuhën shqipe (Arben Ndreca).
- 2 Më hollësisht për këtë shih nekrologjinë për Thallóczy-n të cilën e shkrova në vëllimin më të fundit të Arhiv-it të Jagić-it, XXXVII, 1920, 547-552.

(në vitin 1912 dhe 1922) në lidhje me vazhdimin e punës së filluar, por unë isha i dënuar politik asokohe. Përveç kësaj isha dhe jam i mendimit se asnjë shtëpie botuese nuk mundet t'i dalë llogaria në kushtet e sotme për këtë botim, nëse duhet që përveç shpenzimeve të shtypit të heqë edhe shpenzimet e grumbullimit dhe të redaktimit të dokumenteve. Kjo punë nuk ishte kështu për dy vëllimet e para. Për vazhdimin e kësaj pune shpenzime të tilla do të ishin edhe shumë më të mëdha se në fillim.

Që në shtojcën e vëll. II të AA, vihet re se ne, tre botuesit, për shkaqe të luftës, nuk mundëm të nxirrnim dokumentet origjinale nga arkivi i Vatikanit. Ajo shtojcë në të vërtetë është thjesht shembulli se çfarë pune përgatitore duhet bërë para se të nisë hulumtimi drejtpërsëdrejti në Vatikan. Kjo vlen posaçërisht për shek. XV për të cilin nuk ka *regesta* të tilla si ato që përmbloodhi Potthast dhe Bibliothèque des écoles françaises d'Athènes et de Rome. Megjithatë, unë zotëroj disa kopje dokumentesh jo krejt të njohura të shek. XV nga arkivi i Vatikanit të cilat janë nxjerrë nga hulumtuesi i shquar i historisë papnore, z. Pastor, por këto kopje dokumentesh nuk janë nxjerrë duke u nisur nga këndvështrimi i një kërkimi sistematik rreth Shqipërisë ndër materialet e Vatikanit, por thjesht rastësisht, nga këndvështrimi i studimeve të veçanta.

Për periudhën e përfshirë në dy vëllimet e para të AA, është shqyrtuar me themel arkivi i Dubrovnikut. Jirečeku nga shënimet e tij nxori për AA gjithçka që kishte edhe lidhjen më të përciptë me Shqipërinë, por këto shënime të tija që m'i përcolli mua, arrinin vetëm deri te viti 1406. Sidoqoftë, ky arkiv, duke pasur parasysh Shqipërinë, u hulumtua rishitas deri në fund të shek. XIV. U gjetën rreth 30 dokumente (tek Diversa Cancellarie) të cilat i kishin shpëtuar vëmendjes së Jirečekut dhe në të cilat përmendeshin njerëz nga Arbëria. Sadoqë këto dokumente nuk janë aspak të rëndësishme (do të duhej të dilnin vetëm si *additamenta* - shtesë), prapseprap nga to shihet se as vetë shënimet e Jirečekut nuk janë krejtësisht shterruese për materialin që lidhet me shqiptarët në arkivin e Dubrovnikut. Prandaj, duhet që ky arkiv të shqyrtohet me vëmendje i tëri për shek. XV. Këtë gjë, për shkak të volumit të madh të punës, mund ta kryej si duhet vetëm një grup të rinjsh paleografë krejtësisht të përgatitur, sipas disa udhëzimeve të hollësishme. Si themel të hulumtimeve, përveç punimeve të Gelčić-it, Jorgës dhe të tjerëve do të ishte mirë të shtoheshin edhe kopjet e shënimeve të Jirečekut të cilat qeveria bullgare i pati blerë nga e veja e Jirečekut.

Edhe në arkivin e Venedikut ka nevojë për shqyrtim me themel përvijimin e AA. Edhe këtu do të duheshin disa punonjës të rinj të përgatitur. As Ljubić, as Makušev, as Jorga nuk kanë bërë kërkime të plota në këtë arkiv duke pasur parasysh Shqipërinë. E studioi me kujdes këtë arkiv Makušev. Kopjet e tij të dokumenteve të Venedikut, të lidhura në tre vëllime dhe që atëherë ruheshin në arkivin e bibliotekës së universitetit të Varshavës, u vunë në

dispozicion të Akademisë Jugosllave të Zagrebit në vitin 1900. Kryetari i atëhershëm i kësaj akademie, i ndjeri prof. Smičiklas m'i besoi mua këto, të cilat, meqë ishin të panjohura, t'i përgatisja për shtyp dhe kryesisht vetëm ato që lidheshin me Kroacinë dhe qytetet dalmate. Hulumtimet e Makušev-it arrinin deri në shek. XVII. Unë sipas udhëzimeve që më ishin dhënë e përfundova detyrën time në vitin 1901, por meqë menjëherë pas kësaj u nisa jashtë shtetit ku qëndrova shtatë vjet, nuk bëra qortimet e atyre kopjimeve, të cilat dolën tek seria «Starine» 30 (1920). Më vonë kur nisa të përgatis AA, ngula këmbë që të merrja edhe kopjet e Makušev-it që të gjitha, pra edhe tre vëllimet e lartpërmendura, posaçërisht mandej edhe kopjet e tij nga registrat anzhuinë nga arkivi i Napolit, por gjurmët e të gjithë trashëgimisë shkencore të Makušev-it janë zhdukur. Nëse dëshirohet të vijohet me botimin e AA, atëherë do të ishte mirë të zbuloheshin këto kopjime të Makušev-it si punë përgatitore për hulumtime në arkivat e Venedikut.

Megjithatë, mundem të pohoj plot besim se në arkivin e Venedikut ekzistojnë mjaft *acta* të cilat i kanë shpëtuar vëmendjes së Makušev-it, e nuk po i përmend as Ljubić-in e as Jorgën të cilët nuk kanë marrë Shqipërinë si themel të hulumtimeve të tyre. Unë zotëroj pikërisht disa ekstrakte të shkurta nga librat venedikas: *Misti del Senato*, *Misti Terra*, *Misti Mar* dhe *Consiglio dei Dieci*, deri në vitin 1501. Prej këtyre shihet se aty duhen bërë hulumtime pavarësisht atyre të Makušev-it, Ljubić-it dhe Jorgës, pavarësisht edhe nga shumë materiale që kanë dalë në revistat shkencore italiane.

Pikërisht duke pasur parasysh materialin në Venedik, nuk është e mjaftueshme që AA të përfundojnë me vitin 1479, siç mendohej fillimisht. Do të duhej, me kohë, që hulumtimet të zgjeroheshin deri në vitin 1571, kur venedikasit humbën Tivarin dhe Ulqinin. Pikërisht ky material përfundimtar i shek. XVI është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të gjithë Ballkanin dhe veçanërisht për ata që i përket pjesës shqiptare të tij sepse në këtë shekull ndodhën ndryshime të mëdha shoqërore: u krye involucioni i strukturës shoqërore mesjetare bizantino-serbe; u zhvillua dhe u fuqizua sistemi atavik fisnor dhe u përgatit një lloj njësie shtetërore hierarkike (Mali i Zi, Mirditasit, Himariotët).

Nga ana tjetër, për vijimin e AA nuk është i nevojshëm hulumtimi në arkivat e Barcelonës, Milanos, Mantovës dhe të Palermos. Unë kam kopjet e nxjerra nga këto arkiva krejt deri në vitin 1501. Materiali barcelonas dhe ai mantovan është i rëndësishëm për kohën e Skënderbeut, ndërsa ai milanez veçanërisht për periudhën e ofensivës turke pas vdekjes së Skënderbeut, posaçërisht pastaj për periudhën 1470-1490.

Që vijimi i botimit të AA është një nevojë shkencore e rendit të parë, jo vetëm për ata që i përket këndvështrimit të historiografisë serbe, jo vetëm

përsa i përket njohjes së Ballkanit por edhe nga këndvështrimi i historisë së qytetërimit evropian, për këtë nuk ka nevojë të shpenzojmë fjalë. Po ashtu jam i mendimit se sot qendrat shkencore të Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve – me qëllim studimin shkencor të Ballkanit – jo vetëm që janë të grishura por edhe e kanë me detyrim në të vërtetë që t'i përmbushin ato boshllëqe të cilat u krijuan pas zhbërjes së monarkisë austro-hungareze.

Përktheu nga kroatishtja Arben Ndreca